

**STATUTI I SHOQËRISË DHE AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË ME  
PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
Albania BioConnect Sh.p.k**

Në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, ne themeluesit:

**Klodian Bego**, i biri i Agronit lindur në datë 02/07/1985, në Korçë, banues në Korçë, dhe mbajtës i letërnjoftimit me nr. I50702096R, në cilësinë e ortakut themelues krijon:  
Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar Albania BioConnect Sh.p.k, me seli në Korçë Rr Dhimiter Denasi Nr7 Lagjia 18 Nr pasurie 3/64 zone kadastrale 8561  
Statuti është akti bazë ku do të mbështetet themelimi i shoqërisë tregtare Albania BioConnect Sh.p.k, si dhe zhvillimi i mëtejshëm i saj.

**KREU I**

**NENI 1**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Ortaku i vetëm i kësaj shoqërie, është shtetasi Klodian Bego , i cili zotëron 100 % të kapitalit të kësaj shoqërie.

**NENI 2**

**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

2.1. Shoqëria mban emrin Albania BioConnect Sh.p.k, dhe është person juridik shqiptar.

2.2. Kjo shoqëri e fiton personalitetin e saj juridik, me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

2.3. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në këtë akt.

**NENI 3**

**SELIA E SHOQËRISË**

3.1. Shoqëria Albania BioConnect Sh.p.k, ka qendrën në adresën në Korçë Rr Dhimiter Denasi Nr7 Lagjia 18 Nr pasurie 3/64 zonë kadastrale 8561

3.2. Njësitë strukturore, degët dhe përfaqësitë e saj do të ndërtohen konform legjislacionit shqiptar në fuqi dhe me atë të vendeve të tjera ku ajo mund të hapë degë.

**NENI 4**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

4.1. Qëllimi i shoqërisë është: Menaxhimi dhe monitorimi I provave klinike, mbledhje të prova klinike në popullatë, spitale, klinika mjekesore, laboratore. Ruajtjen, menaxhimin, përpunimin e materialet biologjike gjithashtu dhe të dhënat e tyre në mënyrë të organizuar për qëllime studimi.

Për qëllim të realizimit të objektit të mësipërm të mësipërm, Shoqëria mund edhe: të kryejë cdo aktivitet të ligjshëm që lidhet me pasuri të luajshme dhe\ose të paluajshme, si dhe cdo aktivitet tregëtar, financiar, brenda dhe jashtë vendit. Dhënie me qira ose venien e hipotekave që mund të konsiderohet I dobishëm ose I domosdoshëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë; të fitojë, në

mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, interesa në shoqëri të tjera të cilat kanë një objekt të ngjashëm me atë të Shoqërisë në Shqipëri ose jashtë saj; dhe të kryejë cdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet I dobishëm ose I domosdoshëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.



Për më tepër, Shoqëria mund të kryejë cdo aktivitet tjetër I cili nuk është I ndaluar nga legjislacioni në fuqi. Objekti I Shoqërisë mund të ndryshohet dhe \ose shtohet me vendimin e Administratorit për qëllim realizimin e objektit. Shoqëria mund të ushtrojë veprimtari të tjera plotësuese si: funksioni i laboriatorit ose klinikës që janë të dobishme ose të nevojshme për realizimin e objektit të saj, në përputhje me ligjin Shqiptar. Shoqëria do të bashkëpunojë, lidhë marrdhënie tregëtare me persona të tjerë fizik dhe juridik që ushtrojnë veprimtari të njëjtë dhe\ose të ngjashme në Shqipëri dhe jashtë saj.

4.3. Aktivitetet e sipërpërmendura do të realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar në fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, të miratuar nga Ortaku/Ortakët e saj.

4.4. Shoqëria mund të zgjerojë ose kufizojë fushën e veprimtarisë së saj në çdo kohë.

#### NENI 5 PËRGJEGJËSIA E ORTAKËVE TË SAJ

5.1. Pjesëmarrja në shoqëri nuk pengon pavarësinë ligjore, organizative dhe të pronësisë së ortakëve të saj.

5.2. Ortakët e kësaj shoqërie, nuk janë përgjegjës për detyrimet që lindin gjatë aktivitetit tregtar të shoqërisë, tej kapitalit themeltar të saj, që vetë ata e kanë nënshkruar. Gjithashtu shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet personale të ortakëve të saj.

#### NENI 6 KOHEZGJATJA

6.1. Shoqëria do të ushtroje aktivitetin ekonomik të saj, për një periudhë kohe të pakufizuar nga data e regjistrimit të saj.

#### NENI 7 SIMBOLET E SHOQËRISË

7.1. Shoqëria do të ketë vulën e saj Albania BioConnect Sh.p.k.

#### KREU II NENI 8 KAPITALI I SHOQËRISË

8.1. Kapitali i nënshkruar i shoqërisë Albania BioConnect Sh.p.k, përbëhet nga para me vlerë të barabartë me 1.000 (një mijë) lekë, e barabartë me 1 kuotë/pjesë me vlerë nominale 1.000 lekë, (1 kuotë/pjesë e barabartë me 100 % të kapitalit).

8.2 Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

8.3 Ortaku/ët përgjigjet/n për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

#### NENI 9 TRANSFERIMI I KAPITALIT DHE I KUOTAVE

9.1. Kapitali themeltar ose pjesë të veçanta të tij, janë të transferueshme nga ortaku tek të tretët. Transferimi i kapitalit apo pjesëve të tij nga Ortaku në favor të të tretëve, kryhet gjithnjë me akt juridik të posaçëm. Kuotat e shoqërisë mund të pjestohen për shkak të kalimit të tyre, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.



9.2. Shoqëria mund të zmadhojë kapitalin themeltar ose mund ta zvogelojë atë, por në çdo rast jo nën kufirin e përcaktuar ligjor. Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit behet me vendim të ortakëve të shoqërisë dhe sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

9.3. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

9.4. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të ortakëve të shoqërisë në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

9.5. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

## NENI 10

### TRANSFERIMI I KUOTAVE

10.1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

10.2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

10.3. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të kuotave në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

10.4. Kalimi i kuotave kushtëzohet nga e drejta e parablerjes së tyre, nga ortakët e tjerë të shoqërisë.

## KREU III


### NENI 11

### ORGANI VENDIMMARRËS

11.1. Asambleja e kësaj shoqërie është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë. Ortaku do të ketë të drejta vote në përpjestim me përqindjen e kontributit të zotëruar prej tij në kapitalin e Shoqërisë dhe që përfaqësohet nga Kuota e tij ose pjesë e Kuotës së tij.

11.2. Ortaku/ët i/e saj, vendosin për çështje si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;



- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve;
- g) ndryshimin e statutit, e selisë së shoqërisë, hapjen dhe mbylljen e filialeve të saj.
- h) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.

11.3. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku/ët i/e saj duhet të regjistrohen në regjistrin e vendimeve, të dhënat e të cilit, nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Në regjistrin e vendimeve, duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- d) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

11.4. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

11.5. Asambleja e Pergjitheshme do të mbahet në seline e Shoqërisë ose në cdo vend tjetër brenda ose jashtë Shqipërisë ku Ortaket mund të bien dakord. Vendi i perzgjedhur, data dhe ora si dhe rendi i ditës dhe dokumentat perkatëse në lidhje me mbledhjen duhet t'i njoftohen Ortakeve me anë të postës së regjistruar ose emailit të pakten 7 dite përpara datës së përcaktuar për mbledhjen.

11.6. Për cdo vendim të marre jashtë Shqipërisë një vendim i shkruar duhet t'i dërgohet Administratorit të Shoqërisë. Në rastet kur Asambleja nuk është mbledhur sipas këtij Neni, atëherë Asambleja mund të marre vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë Ortaket janë dakord.

11.7. Çdo Ortak ka të drejtë të përfaqësohet me prokurë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Çdo Ortak ka të drejtë të marre pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve të komunikimit në distancë siç telekonferencat dhe/ose videokonferencat, etj.

11.8. Ortaket pranojnë dhe janë dakort për të vendosur duke shprehur votën edhe në mënyrë të shkruar nëpërmjet qarkullimit të dokumentit të shkruar. Draft vendimi së bashku me rendin e ditës dhe njoftimin dhe dokumentat mbështetëse duhet t'i dërgohet Ortakeve me postë, email ose mjete elektronike të sigurta të pakten 7 dite përpara datës së mbledhjes. Ortaket kanë të drejtë të miratojnë vendimin duke dërguar një kopje të nënshkruar të projekt-vendimit tek Administratorët në datën ose përpara datës së mbledhjes. Ortaket të cilët votojnë kundër duhet të shprehin kundërshtitë e tyre për vendimin në një dokument me shkrim dhe duhet ta dërgojnë atë tek Administratori. Vendimi do të konsiderohet i miratuar nëse kuorumi dhe shumica e kërkuar në përputhje me këtë Statut janë përmbushur.



11.9. Çdo Ortak ka te drejten te votoje ne perputhje me, dhe ne proporcion me vleren nominale te Kuotes se zoteruar prej tij ne kapital.

11.10. Vendimet e meposhtme do te merren me nje kuorum pjesemarrjeje prej me shume se ½ e kapitalit te Shoqerise qe duhet te jete i pranishem ne mbledhje dhe do te miratohen me voten ne favor nga ortaket qe zoterojne te pakten 70% te kapitalit te Shoqerise, i pranishem ne mbledhje:

- a. vendimet ne lidhje me mos shperndarjen e fitimeve apo/dhe me destinacionin e ndryshem te fitimeve te Shoqerise;
- b. ndryshimi i Statutit i cili nuk lidhet me objektin e Shoqerise;

## NENI 12 ADMINISTRATORI

12.1. Administratori i shoqërisë Albania BioConnect Sh.p.k. është z. **Klodian Bego**, i biri i Agronit, lindur në datë 02/07/1985 në Korçë, banues në Korçë, dhe mbajtës i letërnjoftimit me nr. I50702096R

12.2. Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar, me të drejtë ripërtëritje bazuar në nenin 95/1 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

12.3. Administratori i kësaj shoqërie ka të drejtë që, në ushtrim të kompetencave të administratorit, që të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme pranë çdo institucioni privat apo publik, si dhe të marrë të gjitha vendimet në interes të shoqërisë.

12.4. Administratori i shoqërisë mund të caktohet edhe një person tjetër, jashtë ortakut.


12.5. Afati i emerimit per Administratorin eshte 5 (pese) vjet me te drejte rinovimi. Çdo ndryshim i mepasshem ne lidhje me numrin ose personin e Administratorit/reve, nuk do te konsiderohet si nje ndryshim Statuti.

## NENI 13 KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

13.1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga ai vete.
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) te përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të shoqërisë.
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përpara ortakut në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

13.2. Administratori është i detyruar të thërrase mbledhjen e Asamblesë së



Përgjithshme edhe në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

13.3. Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridikë, publike dhe/ose privatë vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.

13.4. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji i'a jep shprehimisht ortakëve.

13.5. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

#### NENI 14

#### VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

#### NENI 15

#### BILANCI I SHOQËRISË DHE DIVIDENTET

15.1. Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, e përberë nga ortakët e shoqërisë miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

15.2. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, e përberë nga ortakët vendos rreth shpërndarjes së dividentit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.


#### NENI 16

#### MBARIMI I SHOQËRISË

16.1. Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakeve të shoqërisë;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar;
- d) me vendim të gjykatës;

16.2. Në këtë rast ortakët e shoqërisë marrin vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe duke shënuar në çdo dokument të shoqërisë emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë



“Shoqëri në likuidim e sipër”.

16.3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pague, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

16.4. Nëse ortakët e shoqërisë nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### NENI 17

#### TRANSFORMIMI I SHOQËRISË

17.1. Transformimi i shoqërisë bëhet me vendim të ortakëve të shoqërisë ose kur ekzistojnë faktorë të jashtëm detyrues ligjor. Në këto raste vendimi merret pasi administratori të ketë paraqitur një raport mbi gjendjen e shoqërisë.

17.2. Çdo transformim i bërë në kundërshtim me këtë nen është i pavlefshëm.

#### NENI 18

#### BAZA LIGJORE

18.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

18.2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, Kodit Civil dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të dalë në zbatim të tyre në Republikën e Shqipërisë.

#### NENI 19

#### MOSMARRËVESHJET

19.1. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të tentohet të zgjidhen me konsensus dhe mirëkuptim.

19.2. Në rast të kundërt, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

#### NENI 20

#### DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

20.1. Ky statut është hartuar me vullnetin e lirë dhe të plotë të ortakëve të shoqërisë dhe është nënshkruar prej tyre

20.2. Ky Statut u redaktua në gjashtë kopje, në gjuhën shqipe, me vlere të njëjtë juridike. Një kopje mbahet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

Korçë, më datë 26/10/2023

**ORTAKU THEMELUES  
TË SHOQËRISË Albania BioConnect Sh.p.k.**

Klodian Bego

